



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostizua / Pamiheno / Prodato Received / Delivered	30.11.2022	2	viti god year
Organ / Shkëmbim Organ / Jedinita Org / Unit	Nr. Prot Ili Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMMSHOK	7502/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.830/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Arben Mehmeti, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 830/2022, të datës 28.09.2022, së ankuesit me adrese banimi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 830/2022 e datës 28.09.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi ne Nr. Prot: 22KA/2 i datës 16.09.2022 i Komisionit të Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Arsyetim

Ankuesi me datë 28.09.2022, me numër protokolli 5714/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën, "Mbikëqyrës në Burgun e Sigurisë së Lartë", si dhe kundër Vendimit datës 16.09.2022, të Komisionit për Zgjidhjen e



se konkursi nuk është bërë në harmoni me U. D MD - Nr. 02/2022 MD-NR. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, sepse testimi me shkrim nuk është bërë në pajtim me dispozitat e udhëzimit të

lartcekur, sepse pyetjet në testim me shkrim janë parashtruar në bazë të Rregullores për Mbrojtën e të dhënave Personale dhe Konfidenciale, e që kjo Rregullore nuk është publikuar në webfaqen e Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe së Komisioni gabimisht ka llogaritur si të pa saktë përgjigjen në pyetjen, masat të cilat duhet ti shqiptohet personit të dënuar për shkelje të rënda, sipas U. D MD - Nr. 02/2022 MD-NR. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovim.

Me datë 02.09.2022, ankuesi me ankesë i është drejtuar Komisionit për Ankesa pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës me pretendimet e lartshënuara.

Komisionit për Ankesa i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 16.09.2022, me numër protokolli 22 KA/2, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Drejtësisë. Ndërsa me datë 14.10.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr 830/2022, datës 28.09.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë e Punës e datës 30.06.2020; Ankesë e datës 02.09.2022 drejtuar Komisionit për Ankesa; Flet kthesë e datës 16.09.2022; Vendim i datës 16.09.2022, i Komisionit për Ankesa; Konkursi i datës 07.06.2022; Vendimi i datës 12.07.2022, për themelimin e Komisionit përzgjedhës; Vendim i datës 12.07.2022 nga Ministria e Drejtësisë; Rezultatet e vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën Mbikëqyrës e datës 31.08.2022; Rezultatet e intervistës me gojë për pozitën Mbikëqyrës; Ftese për intervistë me gojë për kandidatet të cilët e kanë kaluar testin për Mbikëqyrës e cila mbahet me date 30.08.2022; Ftese për intervistë me gojë për kandidatet të cilët e kanë kaluar testin e shkrim për Mbikëqyrës të larte e cila mbahet me date 29.08.2022; Njoftim i datës 23.08.2022 nga Ministria e Drejtësisë; Rezultatet e vlerësimit testiti me shkrim të mbajtur me datë 18.08.2022 për kandidatet që nuk kanë kaluar testin; Rezultatet e vlerësimit të testiti me shkrim të mbajtur me datë 18.08.2022, kandidatet që kanë kaluar testin; Lista e zyrtareve që i kanë plotësuar kriteret për t'ju nënshtruar testit me shkrim për pozitën Mbikëqyrës; Testi me shkrim çelsi; Rezultatet e renditjes përfundimtare të kandidateve për pozitën Mbikëqyrës e datës 01.09.2022; Testi me shkrim i [ ] Testi me shkrim i [ ] Testi me shkrim i [ ] Testi me shkrim i [ ] Kërkesë për punësim e bashkangjitura; Kontratë e punës e datës 11.06.2020; Diplomë e datës 05.09.2007; Vërtetim i datës 06.07.2022; Vlerësimi i rezultateve në punë i vitit 2021; Certifikatë e Muajit korrik të vitit 2019; Mirënjohja e datës 31.12.2014; Vërtetim i datës 15.07.2022; testim me shkrim i [ ] testim me shkrim i [ ] testim me shkrim i [ ] Përgjigje në ankesë e datës 25.10.2022, me numër protokolli 6442/2022, me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.11.2022, me numër protokolli 7076/2022, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka shtyrë edhe për dhjetë ditë, punë afatin për vendosjen, lidhur me ankesën e ankuesit


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesë lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Mbikëqyrës në Burgun e Sigurisë së Lartë“, të publikuara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Ndërlidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesës, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, pretendimi se konkursi nuk është bërë në harmoni me Udhëzimin Administrativ MD - Nr. 02/2022 MD-Nr. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, testimi me shkrim nuk është bërë në pajtim me dispozitat e udhëzimit të lartcekur, pretendim së në bazë të nenit 18, U. D MD - Nr. 02/2022 MD-NR. 02/20221, testimi hartohet në fushën e legjislacionit penal, ekzekutimin e sanksioneve penale, aktet normative dhe Administrative, dhe se në test nuk janë përfshirë pyetje të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrësit, pretendimin së në testimi me shkrim janë parashtruar pyetje në bazë të Rregullores për Mbrojtën e të dhënave Personale dhe Konfidenciale, e që kjo Rregullore nuk është publikuar në webfaqe të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendim së Komisioni gabimisht, ka llogaritur si të pa saktë përgjigjen në pyetjen, masat të cilat duhet ti shqiptohet personit të dënuar për shkelje të rënda, sipas U. D MD - Nr. 02/2022 MD-NR. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovim. Kolegji pasi i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruar në ankesë në Këshill, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara, sepse nga konstatimi i gjendjes faktike, rendësi të veçantë i ka kushtuar testimin me shkrim të ankuesit, dhe nga testimi me shkrim del se ankuesi nuk ka arritur ta kalojë testimin me shkrim, dhe mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton së në konkursin e shpallur 02.06.2022, për pozitën „Mbikëqyrës në Burgun e Sigurisë së Lartë“, nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kriteret e konkursit kanë qenë:

- Diplome e Shkollës së Mesme
- Se paku (3) vite përvoja pune si zyrtar korrektues

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që i ka administruar provat relevante konstatimin e gjendjes faktike dhe bazës juridike, si provë relevante ka marrë për bazë testimin me shkrim të ankuesit, ku ankuesi nga Komisioni përzgjedhës për procesin e





nga Komisioni i Ankesave ankuesit ju kanë shtuar edhe dy pikë gjithsej katër dhjetë e nëntë (49) pikë, me çka nënkuptohet se ankuesi nuk ka arritur të kaloj testin me shkrim.

Kolegji konstaton se Komisioni përzgjedhës për procesin e gradimit, në rastin e vlerësimit të testimit me shkrim ka vepruar në pajtim me nenin 15, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, ku përcaktohet se: *"1. Testi me shkrim përpilohet në dy gjuhët zyrtare dhe mund t'i përmbajë deri 50 pyetje. Çdo përgjigje e saktë mund të vlerësohet deri 2 poena. Testi hartohet për të testuar njohurit në fushën e legjislacionit penal, ekzekutimin e sanksioneve penale aktet normative dhe administrative që normojnë veprimtarinë e institucioneve korrektuese, dhe shkathtësitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit. 2. Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin me shkrim është 60 poena".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore tjera të ankuesit sa i përket zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Mbikëqyrës në Burgun e Sigurisë së Lartë", të zhvilluara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, sepse ankuesi nuk ka arritur pikët e testimit me shkrim, si rrjedhojë Kolegji konstaton se ankuesi nuk mundet të vazhdojë në fazat e tjera të procedurës për pozitën „Mbikëqyrës në Burgun e Sigurisë së Lartë“, për arsye se nuk ka kaluar testin me shkrim dhe pretendimet ankimore tjera të ankuesit janë të pa bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimi ne Nr. Prot: 22KA/2 të datës 16.09.2022, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzim Administrativ MD-NR. 02/20221 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.830/2022*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.